



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 176, Datë 22.06.2026

MBI

ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1081/14 prot., datë 18.06.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.08.2023, i ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën kadastrale nr. 3510, Fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081 prot., datë 03.04.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për saktësim/modifikim të Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 MW.
- Në vijim të këtij aplikimi, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 21.04.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.04.2026 dhe 23.04.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresat nr. 1081/6 prot., datë 27.04.2026, dhe me nr. 1081/9 prot., datë 01.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1081/7 prot., datë 14.05.2026 dhe nr. 1081/8 prot., datë 20.05.2026.
- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit

(OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1081/5 prot., datë 27.04.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1627 prot., datë 19.05.2026, ka paraqitur objeksionet e tij Z. A.Q., të cilat i janë vënë shoqërisë në dispozicion, nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 1627/1 prot., datë 01.06.2026, duke i kërkuar sqarimet/argumentimet për çdo objeksion. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081/12 prot., datë 11.06.2026, ka depozituar sqarimet/shpjegimet në lidhje me objeksionet e paraqitura.
- Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1081/11 prot., datë 10.06.2026, Z. A.Q. ka depozituar objeksione/argumente shtesë në vijim të sa paraqitur më herët nga ana e tij.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 92, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, me qëllim shqyrtimin e objeksioneve të ardhura dhe parashtrimet e depozituara nga shoqëria për këto objeksione, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.08.2023 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë Z. A.Q. dhe shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI